

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në zbatim dhe në përputhje të ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 10 të këtij ligji parashikohet se Fondi financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, në spitalet publike dhe jo publike për personat e siguruar.

Fondi financon Listën e Barnave të Rimbursueshme të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 30.07.2021, “Për miratimin e Listës së Barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, të ndryshuar, ku pacienti përfiton alternativën e parë të barit pa pagesë sipas diagnozës duke respektuar kufizimet e saj dhe protokollet e përdorimit të barnave.

Per diagnozen Skleroza Multiple ne LBR jane te perfshire disa barna:

Bari Interferon beta - 1a 22 mcg (6 MIU), Bari Interferon Beta - 1a 44 mcg (12 MIU), Bari Interferon Beta -1b 250 mcg/ml (8.000.000 Nj.N) dhe bari Fingolimod 0.5 mg.

Ecuria e rimbursimit sipas diagnozes sipas viteve:

| 1004 Skleroza multiple | Nr Pacienteve | Rimbursimi |
|------------------------|---------------|-------------|
| Viti 2020 | 179 | 157,933,112 |
| Viti 2021 | 184 | 165,056,317 |
| Viti 2022 | 166 | 156,561,322 |

Sqarojmë gjithashtu se:

- Procesi i përfshirjes së barnave në listën e barnave të rimbursuara realizohet nga Komisioni teknik i hartimit të listës së barnave të rimbursuara i cili është një komision që krijohet me Vendim të Këshillit Administrativ të Fondit dhe ka në përbërje eksperte nga MSHMS, shefat e disa prej shërbimeve spitalore në QSU "Nënë Tereza", Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe specialiste të Fondit.
- Komisioni shqyrton të gjitha propozimet e ardhura për përfshirjen e barnave të reja në Listën e Barnave të Rimbursuara dhe vlerëson kosto-efektivitetin e tyre si vlerësimin mjekësor për secilin bar të ri të propozuar.
- Komisionit i duhet të vlerësojë rëndësinë e secilit bar të propozuar por dhe impaktin e tij financiar duke pasur në vëmendje buxhetin vjetor të Fondit të miratuar me ligj,

nderkohe qe barnat qe trajtojne diagnoza si Cancer, Skleroza Multiple, Hepatiti C, etj, jane barna me efekt te larte financiar.

- Gjate viteve te fundit Komisioni ka arritur te realizoje marreveshje me disa prej kompanive qe prodhojne barna inovative dhe me kosto te larte, te cilat trajtojne disa diagnoza jetike, te cilat kane ofruar cmime me te uleta per barnat ne rast te perfshirejes ne skemen e rimbursimit.
- Keto marreveshje (MEA) te cilat tashme jane perfshire dhe ne ndryshimet ligjore me te fundit (ndryshimi i ligjit te Barnave dhe Sherbimit Farmaceutik) jane nje nga prioritetet aktuale te MSHMS, per te perfshire me shume barna me kosto te larte ne listen e barnave te rimbursuara sic jane barnat qe trajtojne Sklerozen Multiple.